

RAPORT I PUNËS SË INSTITUTIT TË FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT (IFIN) - 2024

Përmbledhje e aktiviteteve të IFIN përgjatë vitit 2024

1. Takimi me Këshillin e IFIN (27.05.2024)

Më datën 27 maj 2024, është mbajtur takimi i parë në zyret e IFIN, ku morën pjesë Këshilli Drejtues i IFIN, Menaxhmenti i FIN dhe udhëheqësit e Institutit. Gjatë këtij takimi u diskutuan pikat kyçe dhe rrugët për avancimin e mëtejshëm të aktiviteteve të IFIN.

2. Takime dhe Bashkëpunime me Institucione Private dhe Publike

Instituti i FIN, pas konsolidimit të plotë të strukturave të tij, ka organizuar takime të rregullta me kompani private dhe publike me qëllim krijimin e kushteve për bashkëpunim dhe zhvillim të projekteve të përbashkëta. Këto takime kanë shërbyer si platformë për identifikimin e mundësive të reja bashkëpunimi dhe për përmirësimin e aktiviteteve shkencore dhe hulumtuese. Po ashtu stafi I IFIN ka marrë pjesë në mënyrë të rregullt edhe në takimet apo puntorite e organizuara nga menaxhmenti I FIN.

3. Aplikimi për Projektin e Vlerësimit dhe Sanimit të Strukturave të QKSUK

Brenda kuadrit të sponsorizimit të aktiviteteve shkencore dhe hulumtuese nga Universiteti i Prishtinës, IFIN ka aplikuar për projektin “Vlerësimi dhe sanimi i strukturave të QKSUK”. Ky projekt është aktualisht në proces vlerësimi nga autoritetet përgjegjëse.

4. Aplikimi në projekte ndërkombëtare (KUSA dhe IPA)

IFIN ka dorëzuar aplikime për dy projekte ndërkombëtare:


- Projekti KUSA me titull: “The enhancement of human capabilities in the field of research, ëith a specific focus on artificial intelligence, and the development of advanced information technology capacities ëithin the Office for Scientific Research.”
- Projekti IPA në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Maqedonia e Veriut nën IPA III (kontraktues: Komisioni Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë).

5. Hulumtimet shkencore në kuadër të IFIN

Pas kërkesës së parashtruar në Institutin e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit për shfrytëzimin e hapësirave dhe pajisjeve për realizimin e pjesës eksperimentale të punimit të disertacionit në Universitetin e Zagrebit, të një kandidati të jashtëm, Këshilli i Fakultetit ka miratuar këtë kërkesë. Në këtë proces janë përfshirë edhe stafi akademik dhe studentët e nivelit Master, duke mundur një angazhim të gjerë akademik dhe shkencor në fushën e eksperimentimit strukturor.

Eksperimenti po realizohet në një ramë çeliku, e cila shërben si platformë për testimin e sjelljes së ramave të betonit të armuar, me fokus të veçantë në identifikimin dhe verifikimin e sjelljes së lidhjeve (nyjeve) strukturore. Ky hulumtim synon të ofrojë të dhëna të vlefshme për përmirësimin e modeleve analitike dhe dizajnin e nyjeve të ramave të betonit të armuar, duke kontribuar në zhvillimin e standardeve dhe praktikave më të mira në fushën e inxhinierisë strukturore. Ky proces tashmë është në fazën përfundimtare të realizimit, duke përfshirë përgatitjen dhe ekzekutimin e testeve eksperimentale. Vlera e këtij eksperimenti është

10,000 euro, një investim i rëndësishëm që reflekton angazhimin për kërkime cilësore dhe avancimin e njohurive shkencore në këtë fushë.



Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030, MINT

6. Pjesëmarrje aktive në punëtori dhe forume

Në kuadër të projektit për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030, organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Drejtori i IFIN ishte pjesëmarrës në këtë panel diskutime, ku u paraqitën propozime dhe ide konkrete sa i përket fushës së inxhinierisë së ndërtimit si pjesë e zhvillimit industrial në Republikën e Kosovës.




Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030, MINT

Më 27 Shtator 2024, përfaqesuesit e IFIN si dhe pjesë nga stafi akademik ishin pjesëmarrës në punëtorinë e organizuar nga Kompania Prota Softëare ne Shkup. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte prezentimi i produkteve softuerike të kësaj kompanie, të cilat shërbejnë për analizën dhe projektimin e strukturave. Poashtu, në kuadër të kësaj punëtorie u zhvilluan edhe takime të tjera me përfaqësuesit e kësaj kompanie, me qëllim që të sigurohen licencat akademike të këtij softueri për përdorim nga stafi akademik dhe studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit.



Pjesëmarrja në punëtorinë e Prota Softëare në Shkup

Me ftesë nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, përfaqesuesit e IFIN morrën pjesë në Forumin Ekonomik organizuar nga kjo Odë, në periudhën 2 deri 3 Tetor 2024, ku u zhvilluan takime biletale me personalitetet pjesëmarrëse, me qëllim inicimin apo vazhdimin e bashkëpunimeve me sektorin privat dhe institucional.



Pjesëmarrja në Forumin Ekonomik organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

7. Vizitat në IFIN

Një delegacion nga Departamenti i Gjeomekanikës nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Kiril dhe Metodij, Shkup, më 05 Nëntor 2024, ishin për vizitë në ambientet e Fakultetit dhe të IFIN. Qëllimi i kësaj vizite ishte prezentimi i hapësirave të laboratoreve dhe

paisjeve laboratorike që i posedon IFIN në kuadër të Fakultetit, si mundësi për bashkëpunime të mëtutjeshme ndërmjet dy institucioneve me qëllim përfshirjen në projekte hulumtuese ndërkombëtare.



Vizita nga stafi akademik i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Kiril dhe Metodij në ambientet e IFIN

8. Funkcionalizimi dhe furnizimi me paisje të reja laboratorike

Gjatë vitit 2024, ka filluar procesi i funksionalizimit të disa paisjeve ekzistuese në laboratorët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, si dhe furnizimi me paisje të reja laboratorike, konform kërkesave nga departamentet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Këto furnizime arrijnë vlerën prej 600,000.00 euro. Pajisjet kanë filluar të lifterohen dhe kontrata parashikon përfundimin e procesit deri në korrik të vitit 2026. Në kuadër të kësaj kontrate, Drejtori i Institutit, Sekretari dhe Shefi i Departamentit të Konstruksioneve, kanë marrë pjesë në një trajnim njëjavor për njëri nga pajisjet (CPT-Pagani, laborator i Gjeomekanikës) në Milano, Itali, me çrast janë pajisur me certifikata përdorimi të kësaj paisje nga ky trajnim.



Trajnimi për përdorimin e paisjes gjeomekanike CPT, Pagani Company, Milano, Itali

9. Bashkëpunimi me Institucione

IFIN është në kontakte të vazhdueshme me institucione private dhe publike për të avancuar punën dhe projektet e tij. Këto bashkëpunime synojnë zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve shkencore, hulumtuese dhe aplikative të institutit.

Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, vlenë të përmendet edhe takimi i zhvilluar me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Liburn Aliu, i mbajtur me 31 Janar 2024, ku u diskutuan çështje me rëndësi si:

- Formimi i grupeve punuese për inicimin e hartimit të Kodeve të Ndërtimit
- Dakordimi për angazhimin e përbashkët në lidhje me funksionalizimin e Odës së Inxhinierëve
- Angazhimi i studentëve në praktika profesionale në departamente përkatëse brenda MMPHI-së
- Përfshirja e Institutit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në projekte të ndryshme në kuadër të MMPHI-se



Takimi i Menaxhmentit të FIN dhe IFIN me Ministrin e MMPHI-së

10. Përfundim

Instituti i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit ka treguar një progres relativisht të mirë gjatë vitit 2024, përkundër sfidave fillestare të funksionimit të tij. Në fokus të veprimtarisë së IFIN përgjatë vitit 2024 ishte bashkëpunimi institucional, zhvillimi i projekteve shkencore dhe hulumtuese, si dhe avancimi i kapaciteteve laboratorike dhe teknike të tij. Këto aktivitete do të vazhdojnë të intensifikohen në vitet në vijim.

Për përkrahjen e vazhdueshme të aktiviteteve të Institutit, falënderojmë Menaxhmentin e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në veçanti Dekanin Prof. Asst. Dr. Florim Grajçevci, si dhe të gjithë stafin akademik të FIN.

Poashtu, inkurajohen i gjithë stafi akademik i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, për angazhim dhe bashkëpunim më të thellë me Institutin me qëllim të avancimit dhe promovimit të punëve hulumtuese kërkimore për stafin akademik dhe studentët e Fakultetit.